



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 258, datë 11.11.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Henrik Haxhiraj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
2. Z. Henrik Haxhiraj, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, përkohësisht nga data 11.11.2020 - 10.12.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, z. Haxhiraj do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
4. Të njoftohen për këtë vendim z. Henrik Haxhiraj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës Apelit Gjirokastrë dhe Prokuroria pranë Gjykatës Apelit Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETARI
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
BUJAR SHËSHI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**